

**10 ARSYET PËR
DEKRIMINALIZIMIN E**

PUNËS SË SEKSIT

**OPEN SOCIETY
FOUNDATIONS**

KY DOKUMENT OFRON DHJETË ARSYE PSE
DEKRIMINALIZIMI I PUNËS SË SEKSIT ËSHTË POLITIKA MË
E MIRË PËR PROMOVIMIN E SHËNDETIT DHE TË DREJTAVE
TË NJERIUT TË PUNËTORËVE TË SEKSIT, FAMILJEVE TË
TYRE DHE KOMUNITETEVE. HEQJA E NDJEKJES PENALE
KUNDËR PUNËS SË SEKSIT SHKON KRAH PËR KRAH ME
NJOHJEN E PUNËS SË SEKSIT SI PUNË DHE MBROJTJEN
E TË DREJTAVE TË PUNËTORËVE TË SEKSIT NËPËRMJET
STANDARDEVE TË SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË.
DEKRIMINALIZIMI DO TË THOTË SE PUNËTORËT E SEKSIT
KANË MË SHUMË GJASA TË JETOJNË PA STIGMATIZIM,
PËRJASHTIM SOCIAL DHE FRIKË NGA DHUNA.

Punëtorët e seksit janë persona të rritur që marrin para ose forma të tjera të kompensimit në këmbim të shërbimeve seksuale konsensuale, rregullisht ose herë pas here.¹ Punëtori i seksit mund të jetë femër, mashkull ose transeksual. Në shumicën e vendeve, puna e seksit dhe aktivitetet që lidhen me të janë vepra penale.²

Puna e seksit është kriminalizuar jo vetëm përmes ndalesës së shitjes së shërbimeve seksuale, por edhe përmes ligjeve që ndalojnë joshjen e seksit, që jetojnë nga fitimet nga puna e seksit, mbajtjes së bordelit ose blerjes së shërbimeve seksuale. Përveç kësaj, shumë punëtorë të seksit dhe transeksualë përballen me arrestime, ndjekje penale dhe ngacmim për shkak të ligjeve që kriminalizojnë marrëdhëniet intime të seksit të njëjtë. Punëtorët e seksit gjithashtu shpesh penalizohen për vepra jo-penale siç janë bredhja, endja, dhe pengimi i trafikut rrugor. Duke kufizuar lirinë e punëtorëve të seksit për të negociuar përdorimin e prezervativit me klientët, të kenë qasje në shërbimet publike si kujdesi shëndetësor dhe të organizohen dhe advokojnë për të drejtat e tyre, kriminalizimi rrit vulnerabilitetin e punëtorëve të seksit ndaj dhunës, zhvatjes dhe rreziqeve të shëndetit.³

Ky dokument ofron dhjetë arsye pse dekriminalizimi i punës së seksit është politika më e mirë për promovimin e shëndetit dhe të drejtave të njeriut të punëtorëve të seksit, familjeve të tyre dhe komuniteteve. Dekriminalizimi i referohet heqjes së të gjitha ndalesave penale dhe administrative dhe gjobave në punën e seksit, duke përfshirë ligjet që synojnë klientët dhe pronarët e bordeleve. Ai ndryshon nga legalizimi, i cili është një regjim legjislativ i karakterizuar nga rregulloret të rëndësishme - shumë nga të cilat mund të kufizojnë të drejtat dhe mbrojtjen, të krijojnë mekanizma për abuzim nga autoritetet, dhe të kenë efekte të tjera negative mbi punëtorët e seksit. Zelanda e Re dhe Nju-Sauth-Uells në Australi janë dy juridiksione të njohura për industrinë të dekriminalizuar të seksit. Dekriminalizimi shkon krah për krah me njohjen e punës së seksit si punë dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të seksit përmes ligjit të punës dhe rregulloreve të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës.

Kur puna e seksit dekriminalizohet, punëtorët e seksit mund të kërkojnë kushte më të sigurta të punës dhe të përdorin drejtësinë për të kërkuar dëmshpërblim për diskriminim dhe abuzim.⁴ Punëtorët e seksit kanë më shumë gjasa të jetojnë pa stigmatizim, përjashtim social ose frikë nga dhuna. Edhe aty ku puna e seksit është e dekriminalizuar, prostitucioni i të miturve dhe trafikimi me njerëz mund dhe duhet të mbeten vepra penale.

- 1 Shihni p.sh. UNAIDS, Guidance Note on HIV and Sex Work (2012), http://www.unaids.org/sites/default/files/sub_landing/files/JC2306_UNAIDS-guidance-note-HIV-sex-work_en.pdf.
- 2 UNAIDS, Global Network of People Living with HIV, et al., Making the law work for the HIV response (2010), http://www.unaids.org/en/media/unaids/contentassets/documents/priorities/20100728_HR_Poster_en-1.pdf.
- 3 Shannon K dhe Csete J, "Violence, condom negotiation and HIV/STI risk among sex workers," *Journal of the American Medical Association* 304 (5), (2010): 573-74.
- 4 Armstrong L, "Screening clients in a street-based sex industry: Insights into the experiences of New Zealand sex workers," *Australian & New Zealand Journal of Criminology* 47(2), (2014): 207-222. Shih gjithashtu Abel G, Fitzgerald L, Brunton C. "The impact of decriminalisation on the number of sex workers in New Zealand," *Journal of Social Policy* 38(3), (2009): 515-531.

- 5 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Neni. 1.
- 6 Shihni p.sh. Devine et al., "Pathways to sex-work in Nagaland, India: Implications for HIV prevention and community Mobilisation," AIDS Care 22, (2010): 228-237.
- 7 Komiteti Ndërkombëtar për të Drejtat e Punonjësve të Seksit në Evropë, Deklarata e të Drejtave të Punëtorëve të Seksit në Evropë (2005), <http://www.sexworkeurope.org/en/resources-mainmenu-189/declaration-mainmenu-199>.
- 8 Shannon K dhe Csete J, "Violence, condom negotiation and HIV/STI risk among sex workers," 573-74.
- 9 Kinnell, H, "Murder made easy: The final solution to prostitution?" In R. Campbell, & M. O'Neill (Eds.), Sex Work Now 2006 141-168; Cullompton, Willan. Cituar në: Armstrong, Lynzi, "Screening clients in a decriminalized street-based sex industry: Insights into the experiences of New Zealand sex workers." Australian & New Zelanda Journal of Criminology 0 (0), (2014): 1. 16.
- 10 Conger, Kate, "MyRedbook shutdown could compromise sex worker safety, law enforcement resource," San Francisco Examiner, June 27, 2014, <http://www.sfoxaminer.com/sanfrancisco/myredbookshutdown-could-compromise-sexworker-safety-law-enforcementresource/Content?oid=2834783>.
- 11 "Attacks on prostitutes soar after vice 'driven underground' by law," The Scotsman, April 16, 2008, <http://www.scotsman.com/news/attacks-on-prostitutes-soar-after-vice-driven-underground-by-law-1-1164904>
- 12 Armstrong, Lynzi, "Screening clients in a decriminalized streetbased sex industry: Insights into the experiences of New Zealand sex workers," Australian & New Zealand Journal of Criminology 0 (0), (2014): 1. 16.
- 13 Ibid.
- 14 Ministria e Drejtësisë së Zelandës së Re, Raporti i Komisionit të Shqyrtimit të Ligjit për prostitucion mbi Zbatimin e Aktit të Ndryshimeve 2003, (2008).

1 DEKRIMINALIZIMI RESPEKTON TË DREJTAT DHE DINJITETIN E NJERIUT

Një gur themel i të drejtave bashkëkohore të njeriut është se të gjithë njerëzit janë të lindur të lirë dhe të barabartë me dinjitet dhe të drejta.⁵ Ka shumë arsye pse të rriturit kryejnë punë të seksit, pavarësisht nëse ato janë mjeti kryesor, ose i përkohshëm për të mbijetuar, ose një mundësi për të plotësuar të ardhura të tjera.⁶ Disa njerëz mendojnë se puna e seksit ofron paga më të mira dhe kushte më fleksibël të punës. Cilado qoftë arsyeja, puna e seksit është punë, dhe punëtorët e seksit duhet të trajtohen me dinjitet. Punëtorët e seksit në shumë pjesë të botës janë organizuar për të luftuar për të drejtat e njeriut që nuk mund të realizohen plotësisht derisa ligjet penale kërcënojnë qasjen e punëtorëve të seksit në drejtësi, shëndetësi dhe shërbime sociale; çënojnë të drejtën e tyre për punë dhe mbrojtje në vendin e punës; dhe i ekspozojnë ndaj dhunës, diskriminimit dhe arrestimit arbitrar.⁷

2 DEKRIMINALIZIMI NDIHMON NË MBROJTJEN KUNDËR DHUNËS DHE ABUZIMIT

Puna e seksit nuk është e dhunshme për nga natyra; kriminalizimi është ai që vendos punëtorët e seksit në rrezik më të madh. Nevoja për të shmangur arrestimin- e punëtorëve të seksit dhe të klientëve të tyre - do të thotë se punëtorët e seksit të rrugës duhet të lëvizin shpesh në zona më të izoluara që janë më pak të dukshme për policinë, dhe ku dhuna është më e shpeshtë.⁸ Frika nga arrestimi dhe abuzimi i policisë kufizon kohën dhe metodat që punëtorët e seksit mund të përdorin për të kryer kontrolle të sigurisë të klientëve pa u zbuluar nga policia.⁹ Për punëtorët e seksit të cilët nuk janë në rrugë, autoritetet kanë mbyllur edhe forumet e punës së seksit në internet, si Redbook, të cilat u ofronin punëtorëve të seksit mundësi të kontrollit më të hollësishëm të klientëve dhe në këtë mënyrë siguri më të madhe.¹⁰ Këta faktorë, plus mosndëshkimi i vërtetë ose i perceptuar për autorët e dhunës kundër punëtorëve të seksit, vendosin punonjësit e seksit në rrezik të lartë. Për shembull, pasi Skocia solli ligje për kriminalizimin e joshjes në vitin 2007, grupet regjistruan një dyfishim të përdhunimeve dhe sulmeve të raportuara.¹¹ Në juridiksionet që kanë dekriminalizuar punën e seksit si Zelanda e Re, punëtorët e seksit kanë mundësi më të madhe për të kontrolluar klientët, punojnë në zona të sigurta me qasje më të mirë në shërbimet e sigurisë, dhe i drejtohen policisë në raste të dhunës.^{12, 13, 14}

3 DEKRIMINALIZIMI SFIDON ABUZIMIN DHE DHUNËN E POLICISË

Kur puna e seksit është e kriminalizuar, policia ushtron forcë ndaj punëtorëve të seksit.¹⁵ Policia kërcënon punonjësit e seksit me arrestim, poshtërim publik dhe zhvatje. Në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe në Azinë Qendrore, një numër i madh i punëtorëve të seksit kanë raportuar se kanë qenë viktimë e dhunës seksuale nga policia - deri në 90 përqind në Kirgistan.¹⁶ Në Kamboxhia, pothuajse gjysma e të gjithë punëtorëve të lirë të pavarur të seksit janë rrahur dhe gati gjysma janë përdhunuar nga policia; dhe pothuajse tre nga katër punëtorë të seksit në bordelet janë rrahur dhe më shumë se gjysma janë përdhunuar nga policia.¹⁶ Nga Namibia në Serbi, punëtorët e seksit kanë raportuar raste përdhunimi nga policia gjatë mbajtjes në arrest, shpesh pa prezervativë dhe si parakusht për lirim me dorëzani.^{17, 18} Në këto raste policia abuzon me punëtorët e seksit pa u ndëshkuar, pjesërisht sepse punëtorët e seksit frikësohen nga arrestimi ose abuzimi i mëtejshëm për raportimin e këtyre krimeve. Dekriminalizimi fuqizon punonjësit e seksit që të mbledhin guximin për të paraqitur ankesa kundër policëve që veprojnë në mënyrë të paligjshme dhe për të sjellë autorët përpara e drejtësisë pa frikë nga pasojat negative për jetën e tyre. Në Zelandën e Re, 57 përqind e punëtorëve të seksit kanë raportuar se sjellja e policisë ishte përmirësuar pas dekriminalizimit në vitin 2003.¹⁹

4 DEKRIMINALIZIMI PËRMIRËSON AKSESIN NË DREJTËSI

Ligjet që kriminalizojnë punën e seksti bëjnë që punëtorët e seksit të ndjehen të pasigurt nëse raportojnë krimin - duke përfshirë krimet e dhunshme dhe abuzime të tjera - sepse kanë frikë nga ndjekja penale, mbikëqyrja e policisë, stigmatizimit dhe diskriminimit.²⁰ Në Norvegji dhe Suedi, për shembull, shumë punëtorë të seksit raportojnë se prapëjet në të cilat ata do t'i raportonin krimet policisë janë të larta si rezultat i ligjeve që kriminalizojnë punën e seksit.²¹ Dekriminalizimi heq këto lloj pengesash. Pasi Zelanda e Re ndryshoi ligjet e saj në vitin 2003, shumë punëtorë të seksit kanë raportuar se mund t'i drejtohen policisë dhe gjykatës për ndihmë pa pasur frikë nga ndjekja penale për herë të parë në jetën e tyre.²² Në vitin 2014, për shembull, një punëtoresë të seksit në Uelington iu ndanë 25,000 NZD pasi një meanxhues bordeli e kishte ngacmuar në mënyrë të përsëritur, duke shkelur të drejtat e saj sipas Ligjit të të drejtave të njeriut në vend.²³

- 15 Sex Workers' Rights Advocacy Network (SWAN), Arrest the Violence: Human Rights Violations Against Sex Workers in Central and Eastern Europe and Central Asia, (2009), <http://swannet.org/node/1639>.
- 16 USAID, "Violence and Exposure to HIV Among Sex Workers in Phnom Penh, Cambodia," (2006).
- 17 Rhodes et al., "Police violence and sexual risk among female and transvestite sex workers in Serbia: qualitative study," *British Medical Journal* 337(7669), (2008): 560-566
- 18 Arnott, Jayne and Crago, Anna-Louise, "Rights Not rescue: A Report on Female, Male, and Trans Sex Workers' Human Rights in Botswana, Namibia, and South Africa," (2009).
- 19 Abel G., *Decriminalization: A harm minimization and human rights approach to regulating sex work*, (2010) p. 235.
- 20 Decker M R et al., "Human rights violations against sex workers: burden and effect on HIV," *The Lancet HIV and Sex Workers*, 2014 60-73.
- 21 Shihni, p.sh., Edlund C. dhe Jakobsson P., *An annan horisont. Rose Alliance; Rasmussen I. et al. (2014), Evaluering av forbudet mot kjøp av seksuelle tjenester. Vista Analyse AS, (2014).*
- 22 New Zealand Ministry of Justice, Report of the Prostitution Law Review Committee on the Operation of the Prostitution Reform Act (2003), <http://www.justice.govt.nz/policy/commercial-property-andregulatory/prostitution/prostitution-law-reviewcommittee/publications/plrcreport/documents/report.pdf>; Shih gjithashtu Abel G., "A decade of decriminalization: Sex work 'down under' but not underground," *Criminology and Criminal Justice*, February 2014, p. 6.
- 23 "Escort wins landmark case," *The New Zealand Herald*, March 1, 2014, http://www.nzherald.co.nz/nz/news/article.cfm?c_id=1&objectid=11212075.

- 24** Best Practices Policy Project., Report on the United States of America submitted to the UN Human Rights Council for the 9th Universal Periodic Review, (2010), http://lib.ohchr.org/HRBodies/UPR/Documents/session9/US/JS5_%20HSRI_Joint%20submission5_JS.pdf.
- 25** International Women's Human Rights Clinic, CUNY School of Law, Clearing the Slate: Seeking Effective Remedies for Criminalized Trafficking Victims. (2012), <http://www.law.cuny.edu/academics/clinics/iwhr/publications/Clearingthe-Slate.pdf>.
- 26** Ibid.
- 27** State of Arizona v. Monica Renee Jones, Docket No. 513, Superior Court of Arizona, Maricopa County, LC2013-9021636 [case citation pending].
- 28** Mogulescu, Kate & Mullen, Katherine, testimony before the City of New York Comm. on Women's Issues and the Comm. on Public Safety 8, Oversight: Combatting Sex Trafficking in NYC: Examining Law Enforcement Efforts – Prevention and Prosecution, (2011)
- 29** Harcourt C et al., The decriminalization of sex work is associated with better coverage of health promotion programs for sex workers. Australian and New Zealand Journal of Public Health 34(5), (2010): 482-486.

5 DEKRIMINALIZIMI SFIDON PASOJAT E TË PASURIT TË DOSIES PENALE

Në shumë vende, aplikimi i ashpër dhe i njëanshëm i kodit penal bën që një pjesë e madhe e punëtorëve të seksit të kenë dosie penale. Dosiet penale janë shpesh një burim i stigmës, dhe mund të kufizojnë në mënyrë drastike të ardhmen e dikujt. Në disa pjesë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për shembull, njerëz të dënuar për vepra të lidhura me punën e seksit regjistrohen si shkelës të seksit dhe duhet të mbajnë dokumente që identifikojnë veten si të tillë.²⁴ Shkelësit e seksit shpesh nuk kanë të drejtë të marrin kredi, bursa arsimore, apo banesa publike.²⁵ Individët me të dhëna kriminale për punë të seksit përballen me vështirësi të mëdha në gjetjen punës që nuk ka të bëjë me seksin. Politikat e punëdhënësit për kontroll të historiatit dhe kufizimet me licencat e kërkuara për fusha të caktuara të punës e bëjnë të pamundur ndërrimin e karrierës.²⁶ Përveç kësaj, dënimet penale për veprat e lidhura me seksin janë përdorur si bazë për ri-arrestim arbitrar dhe për heqjen e kujdestarisë prindërore.^{27, 28} Vendet që dekriminalizojnë punën e seksit duhet të marrin në konsideratë heqjen retroaktive të dosieve penale që kanë të bëjnë me punën e seksit.

6 DEKRIMINALIZIMI PËRMIRËSON AKSESIN NDAJ SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Lidhet me qasjen më të mirë duke i mbështetur punëtorë në bordelet, dhe me mbështetje të madhe financiare për programet e shëndetit të punëtorëve të seksit. Mbështetje më e mirë financiare do të thotë mundësi më e madhe për të kryer kontrolle shëndetësor në mbrëmje, një tipar i rëndësishëm sepse mbrëmjet janë shpesh koha më e ngarkuar për punëtorët e seksit.²⁹ Dekriminalizimi gjithashtu është treguar të ketë rritur qasjen në prezervativët dhe shkallën e përdorimit nga punëtorët e seksit. Për shembull, në shtetin e australian të Nju-Sauth-Uells, ku puna e seksit është dekriminalizuar, qasja e punëtorëve të seksit në dhe përdorimi i prezervativëve janë më të lartë se sa në juridiksione të tjera australiane që kanë nivele të ndryshme të kriminalizimit. Përveç kësaj, dekriminalizimi mundëson që punëtorët e seksit të punojnë në grupe në të cilat ata mund të organizojnë shërbime shëndetësore të përshtatshme, të arritshme për veten e tyre. Kjo ofron një alternativë të fuqishme ndaj stigmës dhe diskriminimit me të cilat përballen punëtorët e seksit në ndërveprimet e tyre me shumë ofrues të kujdesit shëndetësor. Programi Fuqizimi i shoqëruesëve të bareve (Bar Hostess Empowerment) dhe Programi i mbështetjes në Nairobi, Kenia është një shembull i shkëlqyeshëm midis grupeve që kanë zhvilluar shërbime shëndetësore

dhe që ofrohen në bashkëpunim të ngushtë me komunitetet e punëtorëve të seksit.

7 DEKRIMINALIZIMI ZVOGËLON RREZIKUN E INFEKSIONEVE HIV DHE INFEKSIONEVE SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME

Dekriminalizimi i punës së seksit mund të shmangë deri në 46 përqind të infeksioneve të reja me HIV në mesin e punëtorëve të seksit gjatë dekadës së ardhshme.³⁰ Një studim i kohëve të fundit i botuar në The Lancet arriti në përfundimin se dekriminalizimi i punës së seksit ishte i vetmi me potencialin më të madh për të reduktuar infeksionet HIV në komunitetet e punëtorëve të seksit – madje më shumë se sa rritja e qasjes në trajtimin antiretroviral.³¹ Kur puna e seksit dekriminalizohet, punëtorët e seksit kanë fuqinë të insistojnë në përdorimin e prezervativit nga klientët, dhe kanë më tepër mundësi për të hyrë në testimin dhe trajtimin për HIV dhe infeksione seksualisht të transmetueshme.

Në të kundërt, kriminalizimi dëmton aftësinë e punëtorëve të seksit për të negociuar përdorimin e prezervativit me klientët.³² Prezervativët e dukshëm dhe negociimi i hapur i përdorimit të prezervativëve i kanë vënë punëtorët e seksit në rrezik më të madh nga arrestimi. Kjo i dekurajon punëtorët e seksit dhe klientët nga përdorimi i prezervativit, sidomos në mesin e punëtorëve të seksit në rrugë të cilët janë shpesh në rrezik më të lartë të infeksionit me HIV. Në përgjigje të kësaj departamentet e ndryshme të policisë në mbarë botën kanë vendosur të ndalojnë përdorimin e prezervativëve si dëshmi të prostitucionit kundër punëtorëve të seksit.³³

30 Shannon et al., Global epidemiology of HIV among female sex workers: influence of structural determinants. The Lancet 385(9962), (2014): 55-71.

31 Ibid.

32 Blankenship K and Koester S., "Criminal law, policing policy and HIV risk in female sex workers and injection drug users," Journal of Law, Medicine and Ethics, 30 2013 548-559.

33 Departamentet e policisë të Qytetit të Nju Jorkut dhe San Francisko, dy nga qytetet më të mëdha në Shtetet e Bashkuara, e kanë marrë këtë qasje. Në të dy rastet, këto veprime janë ndërmarrë nga prokurpori i qarkut ose komisar i policisë.

- 34** New Zealand Ministry of Justice, Report of the Prostitution Law Review Committee on the Operation of the Prostitution Reform Act (2003), <http://www.justice.govt.nz/policy/commercial-property-andregulatory/prostitution/prostitution-law-reviewcommittee/publications/plrcreport/documents/report.pdf>.
- 35** Harcourt C et al. The decriminalization of sex work is associated with better coverage of health promotion programs for sex workers. *Australian and New Zealand Journal of Public Health* 34(5), (2010): 482-486.
- 36** UNAIDS, Guidance Note on HIV and Sex Work (2012), http://data.unaids.org/pub/BaseDocument/2009/jc1696_guidance_note_hiv_and_sexwork_en.pdf.
- 37** Jana S et al., "Combating human trafficking in the sex trade: can sex workers do it better?" *Journal of Public Health*, 36(4), (2014): 622-628, <http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/24179187>.
- 38** Rikspolisstyrelsen, "Människohandel för sexuella och andra ändamål, "RPS Rapport, 2014 8.

8 DEKRIMINALIZIMI NXIT KUSHTET E SIGURTA TË PUNËS

Dekriminalizimi bën të mundur krijimin e vendit të punës, rregulloret e kujdesit shëndetësor dhe sigurisë përkatëse për industrinë e seksit. Në Zelandën e Re, për shembull, dekriminalizimi mundësoi përfshirjen e punës së seksit në Ligjin për Shëndetësi dhe Siguri në Punë duke rezultuar në krijimin e udhëzimeve shëndetësore që punëtorët e seksit kanë përdorur për të kërkuar të drejtat e tyre para punëdhënësit dhe klientët.³⁴ Në Nju-Sauth-Uells të Australisë, dekriminalizimi është shoqëruar me reduktimin e riskut nga lëndime në punë dhe pasiguri për punëtorët e seksit në krahasim me juridiksionet e tjera Australiane.³⁵

Dekriminalizimi nxit gjithashtu kushte më të sigurt të punës për punëtorët e seksit duke u mundësuar atyre që të organizohen. Kolektivisht, punëtorët e seksit mund të trajtojnë faktorët e rrezikut në vendet e tyre të punës dhe të insistojnë në përmirësimin e kushteve. Për shembull, mobilizimi i përpjekjeve të Kolektivit të prostituteve të Zelandës së Re kanë qenë vendimtar për të siguruar të drejtat e sigurisë në vendin e punës.

9 DEKRIMINALIZIMI MUNDËSON NJË PËRGJIGJE EFEKTIVE NDAJ TRAFIKIMIT

Trafikimi është një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut që përfshin detyrimin e individëve për shfrytëzim seksual ose punë të detyruar. Punonjësit e seksit mund të jenë aleatë të natyrshëm në luftën kundër trafikim, dhe mund të jenë në pozitë të mirë për t'i udhëzuar viktimat e trafikimit në shërbimet të përshtatshme.³⁶ Për shembull, nëpërmjet një këshilli vetë-rregulluese të drejtuar nga punëtorët e seksit, Komiteti i Durbar Mahila Samanwaya në Sonagachi (Kalkutë) Indi arriti të identifikonte dhe të mbështesë gratë që ishin trafikuar për shfrytëzim seksual.³⁷ Kur lirohen nga kërcënimi i dënimit penal, punëtorët e seksit mund të organizohen dhe të bashkëpunojnë me organet e zbatimit të ligjit.

Përkundër kësaj, ligjet që ndalojnë blerjen e shërbimeve seksuale shpesh promovohen si mjete të suksesshme për të luftuar trafikimin. Megjithatë, nuk ka dëshmi se kjo është e vërtetë. Një Raport i policisë suedeze në vitin 2014 nuk ka konstatuar rënie të trafikimit në vend pas 15 viteve të kriminalizimit.³⁸ Anasjelltas, dekriminalizimi i punës të seksit

nuk shkakton. Kjo ofron një alternativë të fuqishme ndaj stigmës dhe diskriminimit me të cilat përballen punëtorët e seksit në ndërveprimet e tyre me shumë rritje të trafikimit. Për shembull, Zelanda e Re, e cila e dekriminalizoi punën e seksit në vitin 2003, edhe nga Departamenti i Shtetit i SHBA-së është vlerësuar si një nga vendet që bënë punën më efektive kundër trafikimit me njerëz.³⁹

10 DEKRIMINALIZIMI SFIDON KONTROLLIN E SHTETIT MBI TRUPIN DHE SEKSUALITETIN

Dekriminalizimi i punës së seksit njeh të drejtën e të gjithë njerëzve për privatësi dhe liri nga kontrolli shtetëror i panevojshëm mbi seksin dhe shprehjen seksuale. Trajtimi i ndryshëm i punës së seksit nga llojet e tjera të punës janë një shembull i historisë së gjatë të ushtrimit të kontrollit të qeverive mbi autonominë trupore, vetëpërcaktimin, dhe seksualitetin. Dekriminalizimi respekton barazinë gjinore dhe të drejtat seksuale. Ligjet kundër punës së seksit ndërhyjnë në sjelljet seksuale private dhe përbëjnë një formë kontrolli shtetëror mbi trupin e grave dhe personave LGBTI që përbëjnë një pjesë të madhe të punëtorëve të seksit në të gjithë botën.⁴⁰ Ashtu si që shteti kontrollon të drejtat riprodhuese dhe aktet seksuale me pëlqim midis të rriturve, ligjet penale që ndalojnë punën e seksit përpiqen të ligjërojnë moralin me pak respekt për autonominë trupore.

39 United States Department of State, Trafficking in Persons Report (2014), <http://www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/2014/index.Htm>.

40 Personat transgjitorë rrallë janë të mbrojtur me ligj nga diskriminimi në bazë të gjinisë dhe diskriminimi në punësim mund të jetë një faktor që i çon ato të angazhohen në punën e seksit. Shihni, p.sh., K Slamah, S Winter and K Ordek. Stigma and violence against transgender sex workers. RH Reality Check, December 16, 2010, <http://www.rhrealitycheck.org/blog/2010/12/16/stigmaexclusion-violence-against-transworkers>.

Fondacionet e Shoqërisë së Hapur

Fondacionet e Shoqërisë së Hapur punojnë për të ndërtuar demokraci të gjalla dhe tolerante, ku qeveritë janë përgjegjëse para qytetarëve të tyre. Duke punuar me komunitetet lokale në më shumë se 100 vende, Fondacionet e Shoqërisë së Hapur mbështesin drejtësinë dhe të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes dhe qasjen në shëndetin publik dhe arsimin.

Programi i Shëndetit Publik

Programi i Shëndetit Publik i Shoqërisë së Hapur synon të ndërtojë shoqëri të angazhuara për përfshirjen, të drejtat e njeriut dhe drejtësinë, ku ligjet, politikat dhe praktikat shëndetësore bazohen në dëshmi dhe pasqyrojnë këto vlera. Programi punon për avancimin e shëndetit dhe të drejtave të njeriut të personave të marginalizuar duke ndërtuar kapacitetin e liderëve dhe organizatave të shoqërisë civile dhe duke advokuar për llogaridhënie dhe transparencë më të madhe në politikën dhe praktikën shëndetësore.

Fondacionet e Shoqërisë së Hapur

224 West 57th Street

New York, NY 10019 USA

212-548-0100

contact@opensocietyfoundations.org

www.osf.to/health

